



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 854/1 Prot.

Tiranë, më 13.06.2022

V E N D I M

Nr. 116, Datë 13.06.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 92 Regj., datë 02.06.2022, nga Shoqata “Amaro Roma Korça”, kundër Bashkisë Korçë, me pretendim diskriminimin për shkak të “racës” dhe “vendbanimit”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit nga Shoqata “Amaro Roma Korçë”, parashtrohet se:

“Unë drejtuesi i Shoqatës, A. K, në takimet e ndryshme që kam organizuar me komunitetet rome e egjiptiane, jam njohur me problematikën e prezantuar nga banorët e ish-Artistikes Korçë. Në këtë zonë jetojnë 10 familje të komunitetit Rom/Egjiptian (R/E), të cilat janë strehuar aty që në vitin 1993, të pajisura me autorizimin përkatës nga institucionet e asaj kohe. Ata vazhdojnë të jetojnë edhe sot aty, në banesa të palegalizuara, pasi kanë hasur në disa problematika. Në fillim thuhej që toka kishte pronar, ndërsa nga interesimi pranë Zyrës së Hipotekës banorëve u është thënë se toka ishte pjesë e oborrit të një shkolle 9-vjeçare të ndodhur aty, por që nuk ka lidhje me tokën e banesave për të cilat banorët pretendojnë ti legalizojnë. Banorët kanë bërë ankesë pranë Bashkisë Korçë, por ajo nuk lejon legalizimin e këtyre banesave”.

Subjekti ankues, Shoqata “Amaro Roma Korça”, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shprehimisht: “Të vërtetohet diskriminimi i drejtëpërderjët për shkak të

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

vendbanimit e të racës i famijeve të komunitetit rom e egjiptian, lidhur me privatizimin e banesave të tyre njëjloj si dy familjet e tjera që nuk janë komunitet rom e egjiptian”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në nenin 3/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përrjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD-së, të ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përrjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.*

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të Ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.*

Mbështetur në dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, dhe në kërkesat e përcaktuara në formularin e aplikimit, në rastin kur ankesa paraqitet nga një organizatë me interesa legjitime, asaj duhet t’i bashkëlidhet kopja e vendimit të gjykatës për krijimin e organizatës, kopja e statutit të organizatës, kopja e kartës së identitetit, të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.

Bazuar në sa më sipër, Shoqata “Amaro Roma Korçë” është regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 30333, datë 26.05.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kryetar A. K, për një afat të pacaktuar kohor.

Sipas nenit 6, të Statutit të kësaj Shoqate, përcaktohet qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së saj, shprehimisht:

“Qëllimi i Shoqatës është jofitimprurës e në të mirë e interes të publikut dhe të anëtarëve të saj dhe konsiston në:

- *Mbrojtjen e të drejtave të romëve sipas KEDNJ;*
- *Ndjekjen e të drejtës të shkollimit të romëve dhe edukimin e tyre;*
- *Zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme me karakter kulturor, social, argëtues, sportiv;*
- *Zhvillimin e ndërgjegjësimit e romëve lidhur me integrimin e tyre në të gjitha shtresat e shoqërisë;*
- *Mbrojtjen e të drejtave lidhur me identitetin kulturor të romëve;*
- *Të drejtën për t’u grumbulluar në mënyrë paqësore në forume për mbrojtjen e të drejtave të tyre”.*

Bazuar në sa më lart, Shoqata “Amaro Roma Korça” legjitimohet si subjekt përfaqësues i takon përfaqësimin e anëtarëve të minoritetit rom, bazuar në objektin e veprimtarisë së saj, mirëpo, ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për legjitimimin e saj përpara KMD-së, në emër të ankuesve anëtarë të këtij komuniteti.

Për këtë arsye, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për vijimin e procedurës së shqyrtimit të saj pranë Zyrës së KMD-së, me datë 06.06.2022, i është dërguar e-mail Shoqatës², për plotësimin e të metave të ankesës, anës formale të saj³, duke përcaktuar edhe afatin kohor (brenda 3 ditëve).

² Në adresën amareroma@yahoo.com .

³Duhet te saktësohen sa familje R/E banojnë aty numri dhe emrat e tyre (kryefamiljareve);

Një deklaratë e tyre që janë dakord të përfaqësohen tek Komisioneri nga Shoqata, të firmosin të gjitha familjet.

Me gjithë kalimin e afatit kohor të përcaktuar për plotësimin e anës formale të ankesës, nga Shoqata nuk u soll asnjë dokumentacion apo informacion lidhur me sa u kërkua nga Komisioneri.

Pika 1 e 2, të nenit 33, të LMD-së, parashikojnë se:

“1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.

2. Organizata me interesa legjitime mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, Shoqata “Amaro Roma Korçë”, nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë në emër të 10 familjeve R/E, për çështjen e sipërpërmendur, pasi nuk legjitimohet për kryerjen e ankesës për këto familje pa një dokument ku të jetë dhënë paraprakisht miratimi e pëlqimi me shkrim i tyre.

Bazuar në nenin 33/1/2, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”* dhe Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 44, pika 2, nenin 65, gërma b) të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 32, pika 1/b, si dhe nenin 33, pikat 1, 2, e 4/b) dhe 10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

Aplikimet që kanë bërë tek Bashkia për privatizim banese dhe dokumentacionin, si dhe përgjigjet negative se përse nuk është realizuar. Cilat janë familjet jo R/E që iu është privatizuar banesa dhe kur kanë aplikuar për here të fundit?

1. Mospranimin e ankesës nr. 92, datë 02.06.2022, të Shoqatës “Amaro Roma Korçë”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Raca, vendbanimi
Lloji i vendimit: Mospranim